



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 61, datë 09.05.2023

**“PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE, SIPAS KËRKESËS
SË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR KALIMIN
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR
PROKURORINË E POSAÇME DHE REVOKIMIN E SË DREJTËS SË
PRONËSISË BASHKISË TIRANË, SHOQËRISË “UJËSJELLËS KANALIZIME
TIRANË
TË PASURISË NR. 8/123, NË ZONËN KADASTRALE 8330”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, pikën 1/ 1.2, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar si dhe në vijim të shkresës nr. 5666/4 prot., datë 08.05.2023 të Ministrisë së Drejtësisë dhe memos nr. 5666/5 prot., datë 08.05.2023, me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të japë pëlqimin për projektvendimin “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë e Posaçme dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë “Ujësijellës Kanalizime Tiranë të pasurisë nr. 8/123, në zonën kadastrale 8330”, sipas kërkesës përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ky proces, si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme për realizimin e këtij procesi sipas pikës 1 të këtij vendimi, të kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave të nxjerrë për këtë qëllim.
3. Bashkia Tiranë të ndjekë procedurat përkatëse për paraqitjen e kërkesës për të siguruar buxhetin e nevojshëm nga qeverisja qendrore në favor të shoqërisë aksionare “Ujësijellës Kanalizime Tiranë”, për të gjithë vlerën e investimit të kryer sipas procedurës prokuruese për ndërtimin e objektit “Për zyrat qendrore të UKT në rrugën “Jordan Misja”, Tiranë.
4. Ngarkohet Bashkia Tiranë dhe shoqëria aksionare “Ujësijellës Kanalizime Tiranë”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO